



9-15 MARS

JAVA E MBROJTJES



ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA, LEKSION NË KLSM-16

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, ishte e ftuar si “Guest Speaker” në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), ku mbajti një leksion mbi rreshtimin gjeopolitik të shteteve. Aktiviteti u ndoq edhe nga gjeneral brigade Altin Kurti dhe u vlerësua nga pjesëmarrësit si një kontribut i rëndësishëm për kuptimin e sfidave të sigurisë ndërkombëtare.





REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

**NDRYSHO
TË ARDHMEN TË
DHE NDERO**

PËRFITIMET E ST

- Edukim dhe kualifikim
- Ushtarake të West Point
- Zero tarifë studimi
- Trajtim me ushqim
- Trajtim financiar në
- atë viteve të studimit
- Studim gjithëpërfshirës
- Diplomë e vlefshme
- Shkëmbim eksperiencash
- Ushtarake brenda dhe jashtë
- Pension suplementar

**BËHU PJESË
E AKADEMISË SË FORC**

PËRFUNDON PANAIRI “WORK & STUDY”

Panairi informues për maturantët “work & study” i zhvilluar në disa rrethe të Shqipërisë, përfundoi pas takimeve me të rinj të interesuar për programet e studimit në AFA dhe mundësitë e karrierës ushtarake. Aktiviteti do të vijojë në Tiranë më 18–19 mars, ku maturantët do të njihen më nga afër me mundësitë e studimit dhe karrierës nën uniformë.



URË “BAILEY” NË LOZHAN TË MALIQIT

Kompania e Urave e Batalionit të Xhenios realizoi operacionin xhenier për montimin e një ure metalike të tipit “Bailey” në fshatin Lozhan, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq. Ura 15 metra e gjatë u vendos mbi lumin Devoll dhe siguroi kalueshmërinë në segmentin rrugor që lidh fshatrat Gjnikas dhe Osojë, duke lehtësuar lëvizjen e banorëve dhe mjeteve.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

DETYRA
NDERI
ATDHEU

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

CVS

COL'OR
SANTOPIETRO ESSI L'ALBERGO

RIPRESA
ASSISTENZA MEDICA E SANITARIA

FALEMINDERIT QË
SHPËTOVE JETËN TIME

FUSHATA E DHURIMIT TË GJAKUT NË FT

Fushata vullnetare e dhurimit të gjakut përfundoi me pjesëmarrjen e efektivëve të QAPU në Vlorë, të cilët dhanë gjak për njerëzit në nevojë. Solidariteti dhe përkushtimi i tyre treguan rëndësinë e kontributit humanitar për shpëtimin e jetëve.

JM





STËRVITJA “ÇAKALLA 03-2026”

Stërvitja 24-orëshe “Çakalla 03-2026” u përmbyll me sukses, ku 58 kursantë trajnuan aftësitë fizike, taktike dhe leadershipin në kushte reale fushore. Aktivitetin e ndoqën nga afër Komandanti i QAPN-së, kolonel Besim Bala, dhe stafi, të cilët vlerësuan performancën dhe përkushtimin e kursantëve.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



Muhamet
Hasmuajaj



Ismet
Ishulli



Arben
Hoxha

PËRKUJTIM DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Më 12 shkurt përkujtuam rënien në krye të detyrës të Dëshmorëve të Atdheut: kapiten Muhamet Hasmuajaj, toger Arben Hoxha dhe kapter Ismet Ishulli, efektivë të Forcave të Armatosura që u flijuan në mbrojtje të flamurit, të repartit dhe të shtetit përballë banditizmit dhe paligjshmërisë. Sakrifica e tyre mbetet simbol i përkushtimit ndaj rendit, ligjit dhe atdheut.

